



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA HANI I ELEZIT



Datë: 13.05.2025

Komuna Hanit i Elezit

Rrg. Nuri Bushi nr.2

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 neni 17, Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës neni 19 si dhe Udhëzimi Administrativ nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna neni 17, Kryetari i Komunës shpallë për diskutim publik Raportin e Studimeve të Vlerave të Trashigimisë Natyrore në Territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

NJOFTIM

SHPALLJE PUBLIKE DHE PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Komuna e Hanit të Elezit përmes këtij njoftimi fton dhe njofton trupat konsultative, publikun e gjërë, ekspertët e fushave dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre në aspektin e vërejtjeve, sugjerimeve, propozimeve dhe plotësimeve të Raportit të Studimeve dhe Evidentimit të Vlerave të Trashigimisë Natyrore në Territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për Mbrojtje Ligjore nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

Debati publik do të zgjatë 30 ditë- nga data 23.05.2025-23.06.2025 viti.

Shqyrtimi kryesor publik do të mbahet me dt.23.05.2025 (e premte) me fillim nga ora 10.30h në sallën e takimeve të Asamblesë Komunale.

Raportin e studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashigimisë natyrore në territorin e Komunës Hani i Elezit të propozuara për mbrojtje ligjore nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje Ligjore mund ta gjeni në ëeb faqen e Komunës në linkun: https://hannielezit.rks-gov.net/raporti-i-evidentimit-te-vlerave-natyrore-ne-rrethinen-e-hanit-te-elezit_2024/ i cili do të jetë aty nga dt.23.05.2025 viti.

Komentet, vërejtjet, propozimet si dhe sugjerimet e juaja mund ti drejtoni në email adresën: Fatbardha.h.bushi@rks-gov.net apo bardha.bushi@gmail.com. Ose mund ti dorëzoni në kopje fizike në zyrën e Zyrtares Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit – Fatbardha Bushi.

Ju lutemi për prezencë dhe kontribut.

Hani i Elezit
13.05.2025



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi